

## KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS (2019-2021)

### Misioni

ASHAK-u punon për nxitjen, zhvillimin, promovimin dhe avancimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, për ndërtimin e një shoqërie të bazuar në dije. Realizon, ideon dhe organizon projekte shkencore dhe artistike me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor të Kosovës, përmes: botimit të materialeve kërkimore nga fusha e shkencës, e artit dhe kulturës; mbajtjes së aktiviteteve artistike dhe të diskutimeve kulturore, me qëllim të ngritjes së mendimit kritik në Kosovë; promovimit të mendimit shkencor e artistik në Kosovë, dhe përfshirjes së këtij mendimi në rrjedhat globale.

### Situata aktuale

Gjatë vitit 2017, në ASHAK:

1. Ka vazhduar puna në projektin: *Fjalori Enciklopedik* dhe ka përfunduar përgatitja e dorëshkrimit. Mungesa e mjeteve financiare e ka shtyrë finalizimin e botimit për fillimin e vitit 2018 dhe tani dorëshkrimi është në fazën e përgatitjes për shtyp;
2. Ka vazhduar puna në projektin: *Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX* dhe është përgatitur për shtyp materiali i dorëshkrimit: Leksiku shqip i revistës “Përparimi”, 1955-1968, prej rreth 1000 faqesh;
3. Ka përfunduar faza e parë e projektit: *Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)- Qendrat urbane*, dhe është hartuar e miratuar raporti përmbledhës. Bashkë me raport është dorëzuar dorëshkrimi me rreth 400 faqe;
4. Ka vazhduar puna edhe në projektin: *Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore* dhe në projektin: *Korpusi i monumenteve epigrafike antike të Kosovës*;
5. Kanë përfunduar punët në dy projektet e Seksionit të Shkencave të Natyrës: *Kadastri i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë reverse)* dhe *Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës* dhe janë dorëzuar e miratuar raportet e tyre;
6. Janë botuar këto vepra: *Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe -Norbert Jokl; Studime për gjuhën shqipe; Studime të Dardanisë; Arkitektura popullore e Gjakovës; Zbrazjet atmosferike; Osmoza e kundërt; Regjioni lindor i Kosovës; Xeheroret e nikelit dhe të kobaltit të vendit tonë; Katalogu i Ekspozitës-Rexhep Ferri; Poetët akademikë; Katalogu i Ekspozitës-Artistët akademikë dhe Vjetari 2016;*

7. Kanë vazhduar kontaktet dhe bashkëpunimi me instancat ndërkombëtare, akademike dhe shkencore. Përfaqësues nga ASHAK, në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me akademitë e rajonit dhe më gjerë, kanë marrë pjesë në aktivitete të shumta shkencore e artistike: akademik Rexhep Ismajli me ftesë të Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, në Paris, ka mbajtur një ligjëratë për “Dinamikën e shqipes standarde nga vitet '90 dhe perspektivat e zhvillimeve të saj”. Akademik Hivzi Islami ka marrë pjesë në sesionin Ceremonial vjetor të Akademisë Austriake në Vjenë. Akademik Nexhat Daci ka përfaqësuar ASHAK-un në 3<sup>rd</sup> Joint science conference of Western Balkans process/Berlin process, në Paris. Anëtari korrespondent Muhamedin Kullashi ka marrë pjesë në Asamblenë e përgjithshme të Unionit Akademik Nërcombëtar(UAI) në Tokio. Në këtë Asamble UAI pranoi në radhët e veta, me të drejta të plota, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me ç’rast anëtarit korrespondent Muhamedin Kullashi iu dorëzua Fletëdëshmia e anëtarësimit.
8. Ka vazhduar prezantimi i suksesshëm i botimeve në panairët e librit: të Prishtinës, Tiranës dhe Frankfurtit;
9. Nga fillimi i vitit 2018 e deri më tani janë botuar veprat: *Epiri - Pellazgët, etruskët dhe shqiptarët - Shaban Demiraj; Revista Studime 23 dhe Dasma Arbëreshe*. Deri në fund të vitit parashihet botimi i veprave që janë pjesë e Programit të punës për vitin 2018.

## Objektivat

Në kuadër të misionit të saj Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në periudhën afatmesme planifikon realizimin e objektivave:

1. Veprimtaria botuese e Akademisë (botimi i rezultateve të studimeve shkencore) dhe realizimi i aktiviteteve shkencore e artistike;
2. Realizimi i projekteve të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë : *Korpusi i shqipes së folur në Kosovë dhe Fjalor enciklopedik i gjuhësisë* (titull pune). Projekte dy vjeçare.
3. Vazhdimi i punës dhe realizimi i projekteve afatmesme të Seksionit të Shkencave Shoqërore: *Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)* ; *Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore dhe Korpusi i monumenteve epigrafike antike të Kosovës*;
4. Realizimi i projektit: *Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX*, në kuadër të Qendrës Leksikografike Enciklopedike(QLE).

**I. Objektivi i parë** synon realizimin e veprimtarisë botuese dhe realizimin e aktiviteteve shkencore e artistike të ASHAK, të parapara me Programin e punës. Në Programin e punës për vitin 2018, përveç botimit të dorëshkrimeve me rëndësi të veçantë, janë paraparë të organizohen edhe konferenca, tryeza dhe aktivitete të tjera shkencore e artistike, me interes për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit, si dhe konferenca e tryeza kushtuar personaliteteve të njohura të kombit

tonë. Poashtu janë paraparë dhe projekte të reja afatshkurtra dhe afatmesme. Botimet, projektet dhe aktivitetet shkencore e artistike do të jenë pjesë edhe e programeve të punës për vitet e ardhshme.

**II. Objektivi i dytë** synon realizimin e projekteve të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë : *Korpusi i shqipes së folur në Kosovë dhe Fjalor enciklopedik i gjuhësisë* (titull pune).

1. Krijimi i një korpusi të folur të shqipes në Kosovë, nënkupton mbledhjen e materialeve gjuhësore të folura nëpër të gjitha viset e Kosovës, që do t'u shërbente studiuesve në fushë të gjuhësisë në radhë të parë, por edhe në fusha të tjera si antropologjia e sociologjia. Krahas materialit të regjistruar korpusi do të përfshijë të dhënat (brendafolëse) të respondentëve: mosha, gjinia, shkollimi, profesioni, njohja e gjuhëve të tjera, lëvizja nga vendbanimi dhe kontaktet me të folmet e tjera. Ky korpus shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Anketuesit do t'i marrin të dhënat në terren, do t'i regjistrojnë individët veç e veç, do t'i identifikojnë folësit dhe pastaj, me metodat sociolinguistike e dialektologjike, do të intervistojnë respondentë të ndryshëm për ta regjistruar gjuhën dhe kulturën brenda komunitetit. Materialet e mbledhura do të klasifikohen sipas zonave, statuseve shoqërore, moshës, shkollimit, gjinisë dhe mund të transkriptohen për lehtësim studimi. Materiali i plotë do të mbetet bazë shënimesh për studime të ardhshme të gjuhës shqipe. Projekti ka dy faza: regjistrimi dhe arkivimi digjital i materialit, faza e parë, transkriptimi (i pjesshëm) dhe paraqitja, faza e dytë.

2. Krijimi i një Fjalori enciklopedik të gjuhësisë, duke e pasur në mend të parë gjuhësinë shqiptare, do të ndihmojë për normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe. Rëndësia e një projekti të tillë është, para së gjithash, shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Duke e pasur brenda vetes termat e fushave të ndryshme të gjuhësisë, Fjalori do të shërbejë si mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe të interesuarit e tjerë. Redaksia krijon regjistrin e zërave dhe i përzgjedh autorët sipas fushave të caktuara. Caktohen fusha të ndryshme të gjuhësisë (a. fonetikë, b. studime sociolinguistike dhe funksionale, c. gramatikë). Fjalorët e termave të secilës fushë veç e veç publikohen, pasi të kenë përfunduar. Pas përfundimit të të gjitha fushave, publikohet Fjalori i përbashkët enciklopedik i gjuhësisë, të cilit i shtohen sferat e gjuhësisë së aplikuar dhe të fushave të tjera që nuk janë të përfshira në projektet fillestare. Projekti ka disa faza: Fjalorët e fushave një nga një deri në krijimin e një fjalori të përbashkët të të gjitha fushave.

**III. Objektivi i tretë** synon realizimin e projekteve afatmesme të Seksionit të Shkencave Shoqërore: *Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale); Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore dhe Korpusi i monumenteve epigrafike antike të Kosovës* që do të realizohen përmes aktiviteteve:

- Mbledhja e materialeve nga arkivat dhe nga terreni;
- Realizimi i vizitave brenda dhe jashtë vendit;
- Përgatitja për botim e rezultateve të projekteve.

**IV. Objektivi i katërt** synon vazhdimin e punës në projektin afatgjatë : *Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX*, në kuadër të Qendrës Leksikografike Enciklopedike(QLE).

Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit kërkon angazhime të gjera, me specialistë të fushave si dhe kompletimin e kushteve teknike. Vështirësitë rreth ngritjes së kapaciteteve dhe aftësimit teknik e profesional ende nuk janë kapërcyer për shkak të shkurtimeve buxhetore brenda vitit të kaluar, prandaj pritet që vitet në vazhdim të intensifikohet puna.

Për realizimin e objektivave përveç mjeteve financiare dhe përkushtimit nga ana e ASHAK-ut, është më se e nevojshme edhe rritja e numrit të stafit administrativ, kërkesë kjo e vazhdueshme nga ana e ASHAK-ut.

Tabela 1 : Trendet e financimit 2017-2018 dhe vlerësimet 2019-2021

Organizata buxhetore	Viti 2017 Shpenzimi	Viti 2018 Buxhetuar	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar
<b>Total</b>	1,098,580.67	1,240,364.00	1,263,538.00	1,316,090.00	1,533,429.00
Numri i punëtorëve	55	55	55	55	71
Paga dhe mëditje	786,127.00	825,421.00	850,597.00	876,114.00	1,098,486.00
Mallra dhe shërbime	309,414.20	384,943.00	337,941.00	364,976.00	434,943.00
Shpenzime komunale	3,039.47	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale		25,000.00	70,000.00	70,000.00	
<b>Burimet e financimit</b>					
Garantet qeveritare	1,098,580.67	1,240,364.00	1,263,538.00	1,316,090.00	1,533,429.00
Financimi nga të hyrat e AKP-së					
Të hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06					
Grantet nga Donatorët *	2,993.13	8,636.99	6,636.99	4,636.99	2,636.99

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2019-2021)

Politika e re prioritare 1.	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar
<b>Përshkrimi :</b>			
<b>Ndërlidhja e politikës së re me Dokumentet Strategjike</b>			
<b>Total</b>	1,250,911.00	1,313,466.00	1,533,429.00
Numri i punëtorëve	61	61	71
Paga dhe mëditje	892,970.00	918,490.00	1,098,486.00
Mallra dhe shërbime	357,941.00	394,976.00	434,943.00
Shpenzime komunale			
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale			
Burimet e financimit			
Grantet qeveritare	1,250,911.00	1,313,466.00	1,533,429.00
Financimi nga të hyrat e AKP-së			
Të hyrat vetanake			
Financimet nga huamarrjet	-	-	-
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04			
Financimi nga Klauzola e investimeve -06			
Grantet nga Donatorët*			

## Sqarim

Tabela nr.2. e titulluar “Propozimet për politika të reja”, pasqyron mjetet financiare të nevojshme për të mbuluar rritjen e numrit të stafit akademik dhe atij të administratës. Si rrjedhojë e shtimit të numrit të përgjithshëm të stafit (akademik dhe të administratës), rritet edhe masa monetare për shpenzime operative, në kategorinë mallra dhe shërbime (tabela 2).

ASHAK-u, bazuar në Ligjin dhe Statutin e saj, çdo 4 vjet shpall zgjedhjet për zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe avancimin e anëtarëve korrespondent në anëtarë të rregullt- akademik, prandaj është e nevojshme të parashihet dhe të planifikohet edhe shtimi i mjeteve financiare për kompensimin e shpërblimeve, të parapara me Ligjin dhe Statutin e Akademisë.

ASHAK-u ka nevojë të theksuar për rritjen e numrit e stafit të administratës së paku edhe për gjashtë punonjës, kjo për shkak se me shtimin e numrit të anëtarëve të Akademisë është shtuar edhe vëllimi i punës. Njëherësh rritja e numrit të stafit të administratës kërkohet edhe për shkak të

parandalimit të konfliktit të interesit, që është edhe kërkesë ligjore, meqë një punonjës kryen dy deri në tri detyra shtesë. Mungesa e stafit administrativ është sfidë, me të cilën ASHAK-u po përballet që sa kohë, përkundër kërkesave të vazhdueshme.

## **Performanca kyçe**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, gjatë vitit 2017 ka pasur buxhet përfundimtar në shumë prej 1,116,070.00 €, prej tyre në kategorinë e pagave 786,127.00 €; në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 324,943.00 €; në kategorinë e shërbimeve komunale 5,000.00 €. Vitin fiskal e ka përmbyllur me sukses duke realizuar 98.43% të mjeteve të lejuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës synon përfundimin me sukses të botimeve dhe projekteve të saj. Synon poashtu realizimin e konferencave dhe aktiviteteve të tjera shkencore në fushën e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në fushën e Shkencave Shoqërore, në fushën e Shkencave të Natyrës, dhe në fushën e Arteve, si dhe botimin e kontributeve autoriale të tyre.

Nxitja e krijimtarisë shkencore dhe hulumtuese, bashkëpunimi me akademitë e Ballkanit, të Evropës dhe më gjerë, si dhe bashkëpunimi me organizatat e tjera, anëtare e të cilave është ASHAK (ALLEA, Unionin Ndërkombëtar Akademik, Rrjeti Evropian Qendor dhe Lindor, UNESCO, IAP, etj.) mbetet synim i vazhdueshëm që kontribuon fuqishëm në promovimin e shkencës dhe të shkencëtarëve kosovarë.

Raportet e detajuara mbi punën e Akademisë për vitin 2017 janë miratuar nga Kuvendi i Akademisë dhe do të botohen në Vjetarin e saj.